Dekadenca f.2

Apollonia e Agimit f.4

Kronologji e çakreditimit f.6

Gjendja e tualeteve në UP f.8

VesVeseli të universiteteve publike f.10

td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 04 / MARS 2019



editorial



DEKADENCA

Rron Gjinovci

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Redaksia dhe bashkëpunëtorët:
Adea Kondirolli
Etnik Jakupi
Indrit Ferati
Zogë Hasani
Valon Dervishaj
Vesel Veseli
Basri Oruqaj
Premtim Beqiraj
Dibran Hoxha
Gramos Buçinca
Rron Gjinovci

Dizajni:
Visar Arifaj

Kontakti:
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë

Osss! Këtë numër vendosëm me ia kushtu emërusit të përbashkët të gati tana ndodhive e prodhimeve të shekullit tonë. Si në politikë, muzikë e në art pamor, në përpjekje për me u shkëputë prej të vjetrës e prej krizës së vlerave që e ka kap botën mbarë, njerëzimi ka rrëshkitë në nji periudhë dekadente. Sot, president i ShBA-ve mundet me u ba nji njeri i padijshëm e rrenc, çka kemi mendu se është karakteristikë veç e jona si qytetnim i moçëm iliro-pellazg.

Sot, piktura me dy-tri ngjyra shitet me miliona kishe aty ka vlera që shumica e njerëzve nuk i kuptojnë. Sot, muzika konsiston kryesisht në klipe videosh që japin nji mesazh komercial simbas nevojave të sistemit në të cilin jetojmë. Jetojmë në kohën kur gjithçka "e bukur", "e mirë", është e tillë veç mbasi të jetë konvertu në pare, në shumë pare.

Ky lloj ideologjizimi ektremist i kulturës, politikës dhe jetës së përditshme në përgjithësi, ku gjithçka është ose pare (numër) ose e pavlerë, nuk ka lanë pa e prekë edhe akademinë. Dikur universitetet ishin diqysh ma jashta sistemit, për aq sa është e mundun me kenë jashta asaj pjesë e së cilës je, kur është fjala për misionin e tyne. Bile edhe nga vet emni universitet (univers, universal) shihet që qëllimi ishte i nji dije universale, jodomosdoshmënisht e kontekstualizume në hapsinë e kohë, pra idea e universiteteve ish ato me kenë projektus të së ardhmes së nji shoqnie apo shoqnisë njerzore. Sot, prej universitetit pritet me kenë në shërbim të tregut të punës. Nga institucione shkencore, ato dita ditës po shndërrohen në kurse trajnimi për punëtorët që do të punojnë në korporata e kompanira të ndryshme që synojnë profitin. Nga nji vatër e prodhimit të së ardhmes prosperuse, në instrument të privatit për prodhim veglash pune.

Në vendin tonë universiteti përveç që prodhon mungesë aftësie masive, ai punëson në veten e vet nji armatë të njerëzve të patalentum e të padijshëm të cilët janë vendosë në pozitën e profesorit. Nga nji universitet që dikur prodhonte "kuadra" siç u thoshin me respekt të lartë, sot është shndërru në nji fabrikë prodhimi të të papunëve me diploma, me diploma që nuk justifikojnë ndoj aftësi të fitume.

Kjo është dekadence, nga latinishtja decadere, ku "de" do me thanë "ndamje", "shkputje", "poshtë", ndërsa "cadere" që do me thanë "me ra". Pra ramje poshtë, si qysh thotë populli jonë "poshtë ka ra katuni". Përmbledhtas katuni dekadent.

Pa dashtë me u zgjatë e me mbajtë fjalime, po e përmbyllim këtë editorial si nji hyrje në Tempullin e Dijes numër 4, ku dekadenca paraqitet si dukuni në politikë, në profesoriatin e arsimit të naltë ashtu edhe në estradën muzikore. Dhe jorastësisht në këto tri grupe të krahasume e krahasushme me njana-tjetrën, si pishtar të periudhës dekadente.

Le të jetë ky numër nji dëshmi atëherë kur dekadenca ka korrë fitore dhe është ba standard i padiskutueshëm, le të dihet që dikur në mars të vitit 2019, diku në Kosovë, është denoncu dekadenca në kohën kur ajo pat çu kry ma s'shumti. **Osss!**

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky raport është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

Apollonia e Agimit

E themeluar në vitin 588 para erës së re nga kolonizatorët grekë, Apollonia madhështore me gati 60 mijë banorë, e përmendur edhe prej Strabos edhe prej Aristotelit, ishte një qytet që lulëzoi për gati 900 vite.

Hecim para për 1700 e kusur vjetë, edhe madhështinë e këtij qyteti e thirr në mbiemër Ag Apolloni.

Agu i pagzuar n'lindje si Agim nga familja kaçanikase Teneqja, kur u rrit e ndërroi emrin e mbiemrin. Ndryshimi i këtyre nuk është hiç problem për redaksinë, problemi qëndron se çfarë mbiemri po merr? Çka je tu dashtë me thanë me këtë? Cilin problem je tu dashtë me zgjidh? Ose pyetja ultimative, a ta zgjidh përnime problemin?

Para se ma vazhdu me ish-Teneqen, tash Apollonin, po ju përshkruj procedurën e ndrrimit të mbiemrit, përmes shembullit të Hasan Prishtinës.

Hasan Berisha u lind në 1873 në Vushtrri, me prejardhje prindërore nga Polaci i Drenicës. Hasani e kreu gjimnazin në Selanik dhe më pastaj i vazhdoi studimet në Stamboll. Me 1908 për shkak të veprimtarisë së tij politike, u zgjodh deputet i Sanxhakut të Prishtinës dhe mori emrin Hasan bej Prishtina, e që nganjëherë e quanin edhe Hasan Vuçitërrna. Pra, Hasani, emrin e të cilit e mbajnë pafund rrugë, Universiteti i Prishtinës dhe pafund shkolla të tjera, me punë e meritë ia kaloj namin Polacit, Vushtrrisë e edhe Prishtinës prej ku e fitoi mbiemrin. Shih Figurën 1.

Hajde po e analizojmë a ia ka kalu Agim Teneqja namin Kaçanikut dhe Apollonisë. Merr e shohim aplikacionin e tij për pozitën e profesorit te asocuar në UP. Për tu zgjedhur në pozitën e profesorit të asocuar në UP, ndër të tjerash nevojiten tri punime shkencore të botuara në revistë shkencore ndërkombëtare. Shumica e publikimeve të ish-Teneqës në aplikacion nuk janë ndërkombëtare dhe asnjëra shkencore. Vëmendje! - me publikim shkencor kuptojmë një punim, që ka një rezultat të ri e të mbështetur me metodologji hulumtuese, dhe që në fund i nënshtrohet shqyrtimit nga ekspertë ndërkombëtar para se të botohet në një revistë të indeksuar në një nga databazat ndërkombëtare.



Punimi i tretë me të cilin Agu e "plotësoi kriterin" e tri publikimeve shkencore, është "Nova knjizevnost u novoj Drzavi" i botuar në Sarajevske Sveske. Kjo revistë në seksionin "About", për veten e saj, e përdorë emërtimin Notebook (nga anglishtja: fletore shënimesh) dhe askund nuk e përmend fjalën "scientific" (nga anglishtja: shkencore). Të gjitha publikimet e tjera, ish-Teneqja, i ka në revista të Kosovës me përjashtim të njërës në Nemunas që është njifar reviste (pop)kulturore hungareze.

Rezultati: Agimi nuk e kalon namin e Apollonisë, as të Kaçanikut.

Prandaj Agu, për çfarëdo arsye që e ka ndrru emrin, nuk mundet me e ba Apollonia e me mbet serioz e i papërqeshun në publik.




Fig. 1

Fig. 2

FLASH DASH



Në 2018 ORCA publikoi emrat e tetë profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike qe u avancuan në UP, me 5.5 publikime shkencore në vit, duke ia kaluar për gati 6 herë kolegëve të tyre norvegjez. Për aftesitë e tyre të jashtëzakonshme ORCA i quajti SUPERMENË. Historia e UP-së me superheronjë nuk mbaroi me profesorët e FIM, tash kemi karakter të ri në lojë!

Si çdo superhero, karakteri për të cilin do të flasim sot pati fillesa modeste. Prej një autori që shkruante për natyrën e trurit të sekseve: ai i femrës për të folur, dhe ai i mashkullit për të bërë (për të cilat kërkoi falje); në një qenie gjithku-prezente duke dhënë mësim në katër universitete e kolegje. Dashamir Bërxulli, protagonisti i këtij numri dhe prorektor në UP, në vitin 2018 mentoroi tema në Kolegjin Iliria dhe në AAB, duke qenë mësimdhënës në UP dhe në Universitetin e Pejës. Andaj prof. Berxulli pagëzohet me emrin Flash (nga anglishtja: rrufeja), sipas superheroit të Hollivudit.

Tash studentët kur pyesin "ku është profesor Bërxulli?", përgjigja do të jetë "askund, dhe gjithkund."

KITU feston 49 vjetorin e Universitetit të Prishtinës

Më 13 shkurt, Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet (KITU) ka organizu një ngjarje tërë-ditore për të shënuar 49 vjetorin e themelimit të universitetit të parë në Kosovë.

Gjatë ditës, KITU ka organizuar dy debate dhe një ekspozitë për historikun e Universitetit të Prishtinës. Disa nga organizatat anëtare të koalicionit, Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), Organizata Çohu!, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), OJQ Admovere, Qendra për Kurajo Politike (CPC), dhe vet na - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA), kanë prezantu publikimet e tyre gjatë vitit 2018, dhe punën e tyre në fushën e arsimit të lartë.

Debati i dytë ishte mes Ministrit të Arsimit, Shyqiri Bytyqi, rektorit të Universitetit të Prishtinës, Marjan Dema, dhe drejtorit të KEC, Dukagjin Pupovcit. Në debatin e moderum nga Adriatik Kelmendi, dhe të transmetum në Rubikon, kryesisht u diskutua për gjendjen e universitetit, dhe kush ka faj për këtë deregje.

Ekspozita e hulumtuar dhe e kuruar nga OJQ Admovere, përfshinte historikun e Universitetit të Prishtinës nga fillet e saj në 1968, deri në ditët e sotme. Ky historik, herë i kandshëm, si përpjekjet e qytetarëve të Kosovës gjatë viteve 1968, 1981, 1989 dhe 1997 për arsim dhe republikë, e herë i sertë, si skandalet e rektorëve të pasluftës.

Ndërkohë që KITU organizoi ekspozitë për historikun e Universitetit të Prishtinës, e debate për gjendjen e arsimit të lartë në Kosovë, Universiteti i Prishtinës u mjaftua me një celebrim fjalimesh, ku në mesin e tyre shquhet fjalimi i Kryetarit të Kuvendit, Kadri Veselit.

"Është bërë e zakonshme që universitetet të quhen tempuj të diturisë dhe shkencës, mirëpo Universiteti i Prishtinës, në historinë e tij, është më shumë se kaq. Që nga fillimet e tij, ai ishte tempull i vetëdijes sonë kombëtare," tha ai në ceremoninë solemne.

Të fala nga Redaksia e Tempullit të Dijes

Kronologji e çakreditimit

Sqarime nga redaksia:

Agjencia e Kosovës për Akreditim - institucioni i cili akreditron programet e studimit të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë

Këshilli Shtetëror i Cilësisë – bordi vendimmarrës i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i cili i shqyrton të gjitha programet e studimit dhe vendos për akreditimin e tyre

Akreditimi – njohja e një programi të studimit

Riakreditimi – vazhdimi i akreditimit të një programi të studimit

Tërheqja – akreditimi i një programi të studimit tërhiqet dhe institucioni i arsimit të lartë nuk mund të regjistrojë studentë në vitin e ardhshëm akademik - * ky vendim nuk ndikon studentët ekzistues të cilëve ju njihet diploma pas përfundimit të studimeve si diplomë në një program të akredituar

Për secilin program studimi të nivelit Bachelor, institucioni i arsimit të lartë duhet të ketë një doktor shkence të fushës për 60 ECTS, që i bjen 3 doktor shkence për programet e studimit që janë tre vjet, ose 4 doktor shkence për programet e studimit që janë katër vjet. Sipas kësaj logjike, edhe për programet Master duhet të jenë një ose dy doktorë shkence (varësisht nëse programi është një vit ose dy). Për programet e studimit të doktoratës, duhet të jenë tre profesorë të asocuar.

ECTS – një standard Evropian për matjen e volumit të mësimeve duke u bazuar në rezultatet e të mësuarit dhe sasinë e punës që kërkohet për një lëndë

Doktor shkence – në këtë skenar, i bjen një staf akademik i punësuar në një institucion të arsimit të lartë i cili ka të përfunduar studimet e doktoratës

Titujt akademikë – në universitete publike, janë katër tituj akademikë: asistent, profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt

Konferenca e Rektorëve – grupi i rektorëve të shtatë universiteteve publike në Kosovë *në këtë rast, përjashtohet ushtruesi i detyrës së rektorit të Universitetit të Prizrenit, i cili nuk u ftua në takime, dhe nuk mori pjesë në grevën e shpallur nga Konferenca e Rektorëve

Eh tash, mundem me ja nis.

Më 15 dhe 16 janar 2019, Këshilli Shtetëror i Cilësisë në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ka marrë vendime për akreditimin e programeve të reja, riakreditimin dhe tërheqjen e tyre në universitetet publike dhe private. Në këto mbledhje u vendos për tërheqjen e akredimit të 42 programeve të studimit në shtatë universitetet publike të Kosovës, për mungesë të stafit të kualifikuar (referohuni te kriteri i të pasurit të paktën tre doktorë shkence të fushës për program studimi BA, ose dy për MA).

Më 21 janar, Konferenca e Rektorëve kërkoi që të shkarkohen anëtarët e KShC-së dhe të shfuqizohen vendimet e tyre për tërheqjen dhe refuzimin e akreditimit për programet që kanë qenë të akredituara, deri më 28 janar.

Ambasadorja e BE-së, Ambasadori Amerikan, Ambasadori Gjerman, dhe Ambasadori Britanik të gjithë kanë mbështetur vendimet e KShC-së, duke thënë që politika duhet t'i rrijë larg arsimit të lartë.

Në mungesë të shkarkimit të KShC, Konferenca e Rektorëve hyn në grevë më 29 janar. Duhet të kemi parasysh që stafi akademik dhe administrativ i universiteteve publike tashmë ishte në grevë, duke mbështetur grevën e SBAShK-ut. Kështu që, universitetet publike hyn në double-grevë.



Gjatë këtyre ditëve, Konferenca e Rektorëve fillon takime flirtuese me politikanë të ndryshëm, si Kryetari i PDK-së, dhe Kryetari i NISMA-s. Këta politikanë premtuan gjetjen e zgjidhjes për mbylljen e programeve, pa pikë autoriteti në këtë fushë. ORCA bashkë me studentë aktivistë i ka qit do postera cute nëpër qytet, s'di sa i keni pa.

Ndërkohë, Konferenca e Rektorëve e kuptoi që greva e tyne e dytë ishte e jashtëligjshme, për shkak se në Kosovë grevë lejohen të organizojnë vetëm grupet sindikaliste, dhe Konferenca e Rektorëve nuk është sindikatë. Me këtë rast, në një mbledhje të Senatit të Universitetit të Prishtinës më 1 shkurt, të mbyllur për medie dhe shoqëri civile anulohen të gjitha grevat, dhe Universiteti i Prishtinës kthehet në punë me 4 shkurt.

Kaq për sot, shihemi në numrin tjetër. oss!

Perla gjenerale

Për fat të mbarë, rimbush llogarinë brenda objektit të fakultetit

Numri i madh i studentëve në Fakultetin Ekonomik zvogëlon probabilitetin për me hy në treg të punës. Studentët po mësojnë që ta presin të papriturën, ata kanë fillu me mbajt lëndë për dekriptimin e algoritmeve të bastores, të cilës lutemi që t'ia shohin hajrin.




"Albert" Klinaku



Universiteti i Prishtinës po bën përparime sa i perket fizikës teorike, dhe kjo fal Doktorit te Fizikës në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", Shukri Klinaku i cili thotë se teoria e Ajnshtajnit është e paqëndrueshme, madje universitetet botërore i frikësohen konkurrencës.

Profesori Klinaku i Universitetit të Prishtinës në hapa të shpejtë, madje sapo kaloi Universitetin e Kopenhagës, por si duket i ka kalu-ar shumicën e universiteteve të botës, edhe pse jo në rrugë të marë. Edhe pse baza e tij është kundërshtimi i relativitetit për ndryshimin e kohës, ai në një mënyrë ose tjetër e ka vërtetu atë duke u kthyer literalisht në kohë, qindra vjet me parë, në kohën e Newton-it.


Testi C

Nr i aidis, Emir Mbicmri

1 Në shoqërin kishte të drejtë ta shesë ose ta blej bujkrobin bashkë më token

2 Paisjet personale mbrojtëse janë:

3 Puna e dhunshme etyruar a është e lejuar, nëse është e lejuar kur lejohet:

Aidis? AIDS?

Stafi hulumtues i ORCA-s për testet në Universitet, ka marrë një replikë nga profesori ne fjale. Ai ka thënë: "m'falni 1 fmi i vogel e ka shkru". Ndryshe djalit të vogël i falet sepse në shkollën fillore msusja e tij ka marr pushim te lindjes, e msuses i urojmë lindje sa më të lehtë: Ishalla me kallajllak!

Relevancë se jo mahi

Nëse keni pas dilema se cili është roli i Universitetit në shoqëri, në politikë dhe në jetë në përgjithësi, ju ftojmë t'i lexoni disa pjesë të fjalimit të zt. Veseli në fjalën e rastit në manifestimin e përvjetorit të 49-te të UP-së.

Pjesë të shkëputura nga fjalimi i zt. Veseli:

■ "Sikurse të gjithë qytetarët e vendit, edhe ju, me të drejtë ndiheni të brengosur se çfarë është duke ndodhur me vendin tuaj, në dialogun, me taksën dhe me atë që ditëve të fundit është bërë temë e ditës, raportin tonë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës"

■ "Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian duan që mes Kosovës shtet të pavarur dhe sovran dhe Serbisë, të ketë një marrëveshje përfundimtare, që Kosovën do ta anëtarësonte në OKB, në NATO, BE, por edhe Serbisë do t'i hapte perspektivën drejt BE-së"

■ "Dialogu me Serbinë duhet të ndodhë. Duhet t'i besojmë vetes sonë, SHBA-së dhe Perëndimit."

■ "Në rrugëtimin tim tre dekadash politik, edhe me përvojën personale, e di një fakt: populli jonë ka fituar çdoherë kur ka qenë me SHBA-të. E kam parë, e kam ndjerë dhe e kam provuar vetë këtë"

■ "Ju flas si Kryetar i Kuvendit të Kosovës, si njeri që kam komunikim permanent me instancat e larta të politikës amerikane. Nuk ka ndryshim të politikës amerikane për Kosovën."

Çka ka lidhje kjo me përvjetorin e UP-së?!



TEMPULLI I DIJES • MARS 2019, NUMRI 04

Gjendja e tualeteve në Universitetin e Prishtinës —Hulumtim

91%
e studentëve të anketuar kanë shfrytëzuar së paku një herë tualetin në vendin ku studiojnë.

74%
kanë hyrë vetëm për të urinuar, pasi që ishte e pamundur për ta që të uleshin në guaskat e tualetit.

22%
kanë përdorë praktika të ndryshme në mënyrë që të uleshin në guaskë për të defekuar (për t'u dhirë)

43%
pohojnë se nuk ka ujë për t'i pastruar duart

88%
pohojnë se nuk ka sapun dhe palloma për larjen dhe tharjen e duarve

Të gjithë e dijmë se sa i rendësishëm është një ambient i përshtatshëm për të urinuar apo edhe për të defekuar (për tu dhirë). Kësaj problematike më së miri mund të ju përgjigjet dikush që ka qenë në 'zor' dhe është dashur patjetër të shfrytëzoj tualetet e Universitetit të Prishtinës.

Era e tmerrshme, papastërtia dhe dizajni i guaskave të WC-ve në universitetin tonë janë vetëm disa prej problemeve reale me të cilat ballafaqohemi. Shumica prej nesh së paku njëherë e ka ndjerë erën e fortë të ndonjë tualeti publik dhe jemi çuditur se si mund të 'akumulohet' aq shumë erë. E shumë shpesh kemi hasur në ndonjë copë fekale (mut) që në disa raste ka qenë edhe jashtë guaskës, pra në qeramikë! Tmerr i vërtetë mirëpo kjo nuk është e jashtëzakonshme në tualetet e fakulteteve dhe bibliotekave të Universitetit të Prishtinës.

Në një anketë të realizuar nga ekipi i gazetarisë hulumtuese të TD-së del se rreth 91% e studentëve të anketuar kanë shfrytëzuar së paku një herë tualetin në vendin ku studiojnë. Arsyet pse studentët e Universitetit të Prishtinës kanë përdorë tualetet janë të ndryshme. Shumica e tyre (rreth 74%) pohojnë se në WC kanë hyrë vetëm për të urinuar, pasi që ishte e pamundur për ta që të uleshin në guaskat e tualetit.

22% e të anketuarve kanë përdorë praktika të ndryshme në mënyrë që të uleshin në guaskë për të defekuar (për tu dhirë), ku 63% prej tyre kanë 'izoluar' guaskën me palloma, kurse 37% nuk janë ulur fare dhe kanë shfrytëzuar një teknikë të veçantë duke mos kontaktuar fare me sholen e WC-së. Kur flasim për problemet me ulje në shole, nuk mund ti anashkalojmë asnjëherë sholet e stilit 'zhag për toke', pra guaskë e rrafshtë. Edhe pse shkencërisht është vërtetuar që ky dizajn i sholes është më i shëndetshëm (sidomos për sëmundjet me zorrë (hemorroide)), kur shohim këtë lloj të sholes vetvetiu lindin disa pyetje: Si mund të dhihet një profesor i joni, që mund të jetë në moshë të shtyer e me probleme të mëdha reumatike? Apo edhe: Si mund të ulet një student me model pantollonash të ngushtë? Kjo çon në ngushtim të enëve të gjakut, ndalje të qarkullimit të gjakut e rrjedhimisht në mpirje të këmbëve gjunjë e teposhtë! Zoti i nimoftë

Problem që ja vlenë me cekë është edhe uji në sholet e fakulteteve dhe bibliotekave. Gjatë hulumtimit është vërejtur se shumica e WC-ve nuk kanë ujë për ta pastruar anusin, e disa prej tyre nuk kanë as ujë në rezervuarin e guaskës, apo në rastin më të keq, nuk janë të kyçura fare në sistemin e ujësjellësit.

Studentët përballen edhe me një sfidë tjetër pas kryerjes së nevojave fiziologjike. Aty nuk ka ujë për t'i pastruar duart. Kështu thonë rreth 43% e të anketuarve, kurse prej tyre 88% pohojnë se nuk ka sapun dhe palloma për larjen dhe tharjen e duarve. Mungesa e sapunit është kritike sepse pa sapun duart nuk pastrohen nga të gjitha bakteret, gjë që potencialisht mund të çoj në përhapje të sëmundjeve të ndryshme infektive. Sa i përket pallomave, ato shihen si lluks në tualetet tona. Mungesa e këtyre dy elementeve të rëndësishme po çon në një situatë të pakëndshme, larje të duarve pa sapun dhe tharje të tyre në pantollona.

Tualetet e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës frekuentohen edhe nga studentë të cilët hyjnë në tualet vetëm për tu shikuar në pasqyrë me qëllimin që ti rregullojnë floktë. Po, po! Kështu së paku janë përgjigjur disa të anketuar. Sipas anketës sonë rezulton se rreth 4% e studentëve shkojnë në WC vetëm për këtë aryse, ndonëse në shumicën prej tyre nuk ka fare pasqyrë. Ktu nuk ka vend për shumë kritikë pasi që ky problem është tejkaluar me shpikjen e telefonave të mençur me frontcamera.

Pastërtia është faktor tjetër me shumë rëndësi në tualetet e universitetit tonë. Në pyetjen se si e vlerësojnë pastërtinë në tualetet e Universitetit të Prishtinës, të anketuarit tonë janë përgjigjur duke notuar me 1 deri në 10, ku 1 nënkuptonte 'shumë i pakënaqur' , kurse 10 nënkuptonte 'shumë i kënaqur', studentët kanë vlerësuar tualetet e universitetit tonë me notën 4.12 . Sigurisht nuk është pritur rezultat më i mirë duke parë keramikat e papastruara, plot me gur gëlqeror dhe me mbishkrime si "A <3 E" , "OTR 4 LIFE" apo edhe mbishkrime tejet ofenduese si "Ti që e lexon qeta ma hongsh k**in".

Perla gjenerale




Osss!

Në janarin e këtij viti, profesori Blerim Rexha kishte postu këtë foto specifike në rrjetin social Fejsbuk. Disa shokë fejsbukoz kishin komentuar : "Osss! Pershendetje profo", "Kujdes po t'del arusha kusho, osss!", "Profesor, a e akreditun drejtimin?, Osss!", "Tezak kush t'a ka prish disponimin Osss!".




Pse jo?

Njonin n'mahall e pat nxon baba tu pi cigare edhe ia pat bo "pse pe pin bre djali jem?", ai befas ia ktheu: "e pse jo?". A thua sa është rritur ky djalë dhe a thu me çka merret?



Lajmërohen studentët se profesori është në marrëdhënie pune, WHAT???

Kolegjet tona privat dijnë të na befasojnë me përgjegjshmërinë e tyre. Përgjatë muajit janar dhe shkurt ky kolegj ka lajmëru studentët rreth 43 herë për shtyrjen e provimeve, ligjëratave apo edhe konsultimeve.



Poshtë mundeni me pa se për disa shtyrje kanë arsye të bollshme sepse profesorët mund të jenë në marrëdhënie pune kurse mbajtjen e provimeve në këtë kolegj e kanë vetëm hobi.

VesVeseli të universiteteve publike

Rektorët e Universiteteve publike në Kosovë të cilët dështuan me e justifiku mosakreditimin e disa programeve në universitetet e tyne, u mblodhën urgjentisht për me diskutu rreth kësaj çështje në grupin terapeutik për ngushëllimin e njëri tjetrit, të qujtun: "Konferenca e Rektorëve".

Kjo konferencë doli me kenë frutdhanëse ngase aty u morën vendime t'randsishme që në fund u kurorëzun me ribashkimin e dashnive të vjetra. Me mbajtjen e konferencës dhe me qëndrimet e tyne rektorët u tregun shumë serioz (hin n'grevë, dil prej grevës), të palëkundur dhe sy patrembur.

Mas shumë diskutimesh e reflektimesh rektorët dolën me konstatimet krejt të paqëndrueshme, njani prej konstatimeve ishte se anëtaret e KShC-së kanë lidhje me politikën, gjersa nji hulumtim i preportr[1] tregon se katër nga gjashtë rektorët e universiteteve publike në Kosovë kishin pasur lidhje më PDK-në, shtojmë këtu edhe rektorin e Universitetit të Prishtinës i cili e kishte provu fatin në vitin 2010 kur kandidonte nga lista e PDK-së për deputet. Tash e keni parasysh kush i ka ngrit kto akuza për politizim të Agjensisë së Akreditimit. Si rrjedhojë, kur konstatimet janë qesharake edhe kërkesat janë po ashtu qesharake, rektorët vendosën me hi ngrevë duke dhanë ultimatume për plotësimin e kërkesave të tyne.

Rektorëve nuk u ndihmoi as takimi me Komisionin Parlamentar për Arsim, organi më kompetent ku kta kishin mujt me i adresu "shqetësimet"... Prit, prit! - se ka organe institucion mi institucione Kosova. Ups, dy politikanë?! - Kadri Veseli e Fatmir Limaj.

1 http://preportr.cohu.org/repository/docs/14_-_Universiteti_si_Fushate_-_01_(1)_(1)_707123.pdf

Vesi nuk hiqet leht nga koka, as Veseli jo.
Urime Shën Valentini!

Rektorët e bashkum përtej çdo logjike institucionale vendosën me u taku me zt. Veselin dhe zt. Limaj për me diskutu rreth ktyne zhvillimeve, por, këtë punë s'duhesh me kqyr me logjikë, po me ndjenja (emocione) se ato shpeshherë triumfojnë si në rastin e rektorëve.


Kur çdo rrugë mbyllet, dashnia e vjetër t'pret me dur hapun, edhe kta dorë për dore sy patrembur u nisën drejt rrugës së vjetër. Po i përfytyroj në sfond me kangën e Medës: Ah dashni, dashni e vjetër...

Madje, madje, krejt këto flirtime nuk kanë ndodhë në kohë t'rastësishme, por në vigjilje të Shën Valentinit. Rektorët e dinin se nostalgjia rikthehet në data të veçanta dhe në këto data romantike gjasat për refuzime janë të vogla, andaj vendosën me bo hapin e madh drejt zgjidhjes së problemeve, hapi drejt Kadriut e drejt Fatmirit. (shën. i redaksisë: "ky është një hap i vogël për ne, por hap i madh për rektorët). "Niko ne sme da vas bije" (nga serbishtja: askush nuk guxon t'ju rrahë), dukeshin takimet e rektorëve me Veselin. Por Shën Valentini në horizont i bënte të dukeshin shumë ma romantike.

Redaksia e Td-së uron që ky flirtim t'kurorëzohet me dashni t'sinqertë e t'njëmendtë, mbase me ndonjë bashkim të ri të ndonjë rektori me partitë në fjalë e me tentime ma t'suksesshme drejt pozitave politike.

Si garanci për vazhdimin e romancës zt. Veseli u ftu në ceremoninë e përvjetorit të Universitetit të Prishtinës, ju ftojmë t'i lexoni disa pjesë të shkëputuna nga fjalimi i tij rrënqethës në faqe 7.

KRONIKA E ZEZË



Auto-correction

Asistenti i Regjisë së Filmit ne Fakultetin e Arteve, Durim Kryeziu, reagon ashpër ndaj publikimit të një kritike të Lëvizjes Vetëvendosje, për ditën e Pavarësisë së Kosovës.

Asistenti i entuziazmum, krenarë e shumë patriot ne ditën e Pavarësisë me bindjen se gjithçka është në rregull në Kosovë, i ofendoi pjestarët e Lëvizjes Vetëvendosje në rrjetin social Facebook. Mirëpo, si duket asistenti hyn ne grupin e hoxhallarëve me thënien: "Mos bani çka t'baj une, po bani çka t'tham une", pasi që për pak kohe asistenti në një formë qoftë ironike, kërkon nga një i afërm i tij të pastroj fjalorin.

Redaksia e TD shpreson qe edhe nëse Asistenti Kryeziu nuk do mund te përmbahet në këtë aspekt, ai do këshilloj në të njejtën mënyrë edhe studentët që të ken' kujdes në të shprehur

Asistenti i Fakulteti të Mjekësisë Kujtim Kastrati bie pre e "shikimeve vrastare"!

Një studente e Fakultetit të Mjekësisë ka denoncuar asistentin e kësaj njësie akademike me akuzën për ngacmim seksual. Asistenti Kujtim Kastrati i kishte shkruar asaj në orët e vona duke i shkruar se shikimet e saja ishin vrasëse për të dhe tekste të tjera të kësaj natyre. Këshilli i fakultetit ja ka ndërpre kontratën.

Ish asistenti Kastrati nuk është se i ka mohuar mesazhet, por ka deklaru se e tëra ishte nji keqkuptim dhe se qëllimi i tij ka qenë me ia uru festat e fundvitit.

"Unë thjeshtë kam dashur që ta uroj për festa asgjë më shumë. Unë kam dhënë deklaratën time edhe kam tregu që nuk ka pasur asgjë më shumë se sa kaq. Thjeshtë për ta uruar për festë. Nuk kam çfarë të shtoj më shumë se kaq", përfundoi Kujtim Kastrati.

Ne e admirojmë guximin dhe seriozitetin e menaxhmentit të Fakulteti të Mjekësisë të cilët e kanë shqyrtu me profesionalizëm këtë rast dhe kanë marrë vendimin e duhur për përjashtimin e asistentit Kastrati.

Universiteti i Prishtinës me rënje të lirë në WEBOMETRICS

Përmes nji fushate t'jashtëzakonshme Universiteti i Prishtinës krenohej me arritjen e tyre në rankimin e listave të Webometrics[1] , natyrisht ne ishim t'kanqun me këtë arritje ndonëse rankimi ka të bëj me vetëm me matjen e cilësisë së web-faqes së Universitetit, domosdo ky rankim reflekton përmirësimin e disa kritereve bazë të cilësisë ne Universitetin e Prishtinës.

Por, siç ndodh shpesh herë arritjet tona ndodhin sikurse në ëndërr, kur zgjohesh e sheh që nga vendi 1471 ke rënë në vendin e 2668, krejt kjo në hark javor të kohës.

UP-ja doli me një deklaratë duke u arsyetu se rënia nga rankimi i Webometrics ka ndodh për shkak se në kuadër të Universiteti të Prishtinës është përfshi edhe Universiteti i Prishtinës në Mitrovicë të Veriut, gjë që është totalisht e pavërtetë, sepse Webometrics ka vlerësuar dhe renditur edhe Universitetin e Prishtinës në Mitrovicë të Veriut si të ndarë nga ai i Prishtinës.

Menaxhmenti i UP-së e mori në dorë situatën duke i përmirësuar këto shifra në web-faqen e tyre, domethënë vetëm një ndërhyrje e vogël në tekst nga 1471 në 2668, pjesa tjetër e tekstit me plot krenari dhe mburrje mbetet e njëjta.

Ne i përgëzojmë forcat "progresive" brenda Universitetit për këtë arritje dhe ua rikujtojmë se 59% e stafit akademik të UP-së nuk i justifikojnë titujt akademik dhe se 33% e profesorëve kanë të paktën një punim në revista të dyshimta.

Shnet e keni.

1 Platformë që mat cilësinë e web-faqes së universiteteve botërore

Kronika Rosé



Estrada e UP-së po ashtu ka probleme serioze me plagjiaturë dhe integritet akademik.



A është gjynah që jeton në Kosovë?

Marilyn Monroe e estradës sonë e pazëvendësueshmja Mihrije Braha apo Miki (K'shtu e thirrum veç na shoqnia e ngushtë) e ka tepru edhe një herë tjetër me dozen e lartë të kreativitetit të saj, duke na e sjellë këngën "Dja dja" në shqip, në stilin ku ki me festu vitin e ri? - te xhaxha, te xhaxhi (qishtu u kan e mendume). Ajo është deklaruar se e konsideron vetën një femër të kompletuar dhe kogja shumë intelegjente. Me të vërtetë Miki tashmë është kompletuar edhe për nga plagjiaturat, urime! Ndërsa ne me padurim po presim ditën e lansimit të bashkëpunimit të bijave tona: Dua, Bebe, Rita dhe Miki.

Këshilla të arta nga Prof.Dr.Mihrije Braha: "Nëse jau nxen dera e kerrit gishtin, pshtjellne me gjethe dhe lidhne me fllaster të rrymës", efekte të jashtëzakonshme për vetëm 24 orë. Me këtë punim shkencor po presim që edhe Mihrija të aplikojë për titullin profesor në UP. Lumet na! (Urime viti i ri, o njeri)

Oferta e fundit: bëj plagjiat dhe avancohu! (nformacioni nga Admovere)

Beqir Sadikaj profesor në fakultetin juridik dëshmohet se librin e tij "Sociologjia Juridike" (2006) e ka vjedhur komplet nga vepra "Sociology of Law " e autorit Georges Gurvitch. Libri i "tij" është krejt përkthim madje pjesë pjesë duhet me u ndalë e me analizu kogja si shumë sepse është i përkthyer keq e pa kuptim, duke filluar që nga titulli "Sociologjia Juridike" që do të duhej të ishte "Sociologjia e së Drejtës". Pas akuzave Senati morri vendim për degradim të pozitës së profesorit por më vonë vendimi u shfuqizua (senat pishmanli). Edhe pse profesori në fjalë ka bërë plagjiat e qe besa edhe e ka përkthyer për faqe t'zezë në vitin 2012 duke përfituar nga oferta, Sadikaj është zgjedhur anëtar i Këshillit Drejtues të UP-së, post të cilin e mban edhe sot.

Liria Rozé në rrezik!

Që dëgjimi i muzikës ndikon në rritjen e konsumimit të drogës tashmë veç është vërtetuar nga komisioni parlamentar për punë të kota në krye me mjekun Haxhi Avdyli të cilët shkurt e shqip kanë ardh me një konkludim që nëse e dëgjoni Taynën, shumë lehtë mundeni me pa veten tu konsumu droga - kujdes nga Tayna! Sipas Haxhi Avdylit këto këngë duhet të cenzurohen ndërsa ne duhet të dëgjojmë më shumë këngë të llojit "Mfal nanë , mfal babë " që sipas komisionit ka shumë më shumë vlera artistike.

Kur flasim për vlerat artistike këtu vjen në shprehje eksperti i vijave të holla dhe të trasha aty-këtu Fisnik Ismajli, që deklarohet se mes artistit dhe performuesit ekziston një vijë e hollë të cilën po get Fisi e ka studiu kogja shumë.

Shumë e fortë kolumbiana-na-na-na, bohet tym mari*uana-na-na-na… (pasojat e cenzurës).



Lirim Isufi - student i Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

Profesori "Karatist"

Siç e dimë që të gjithë, historikisht ne Shqiptaret kemi qenë të apasionuar pas filmave aksion. Herë të nxitur nga Bruce-lee e Arnold Schëarzenegger e herë nga ylli ynë kinematografik Halil Budakova, frustrimet dhe inatet ndaj njëri-tjetrit i kemi shprehur përmes dhunës. Këtë më së miri e ka dëshmuar një profesor nga Universiteti i Prishtinës.

Një ditë prej ditësh, profesori kishte qenë si mos më mirë duke shpjeguar për komponimet radioaktive, dhe "fap" i kishte kaluar nëpër mendje një ngjarje dramatike, që i kishte ndodhur në tempullin e dijes. Me zërin e tij me nuanca patriotike, i përbetuar të bënte më të mirën për studentët, kishte filluar rrëfimin e ngjarjes.

Atë ditë të bukur me diell, kur të gjithë profesorët, truri i Kosovës, ishin mbledhur në kafen përballë fakultetit, e me zemër në dorë po diskutonin për të arriturat e shkëlqyeshme të fakultetit, njëri nga profesorët më injorant, i cili kishte përfunduar studimet në disa universitete të lodhta Evropiane, dhe kishte veç 60 punime shkencore krejt, kishte guxuar të fliste për ngecjet në arsimin universitar. Sikur në serialet turke, një heshtje e frikshme kishte mbizotëruar, dhe profesorët me fytyra të shokuara kishin vështruar njëri-tjetrin. Kjo është shpifje, shpifje, gënjeshtër! Ti je argat i atyne atje, ata që s'ja dojnë të mirën këtij shteti, ke ardh ktu edhe na shet mend neve me 60 punime shkencore, a se din që pak me mu tek mu 61 i boj për ni natë! I mecmi i dynjas! – Për një moment në sfond kishte filluar një këngë e Unikatilit!!! Sic thotë fjala e urtë " As luani s'është ma i rrezikshum se Shqiptari kur e dëgjon Unikatilin".

Dhe njëri nga profesorët, i cili vlen të ceket që kishte shërbyer edhe gjatë luftës, u ngrit nga vendi dhe me një shuplakë të fortë si guri i ra profesorit injorant. Kështu e përshkruan profesori hero, momentin: "Si ti kom ra shuplak, birit t'dreqit, sytë xixa-xixa i kanë qit. Aj u met mëm kallzue mue për integlitetin akademik. Hup bre i dërguem i sërrbis , a ja ke pa ftyrën maspari"


Ca zogj në një pemë afër kafenesë, u trembën nga zhurma e duartrokitjeve brenda.

Deri sa kënga e Unikatilit po vazhdonte, profesori ndjente krenari në gjithë trupin e tij. Më në fund kishte goditur me një shuplakë të merituar njeriun që e përgënjeshtronte punën e tyre madhore e përparimtare. Kur rrap-tap u kthye në botën reale, profesori e vërejti se studentat ishin mallëngjyer shumë. Pas kësaj ngjarjeje dramë-aksion, nuk kishte kuptim të vazhdonte shpjegimin, sepse edhe interesimi I studentëve kishte humbur. Hajt msone te shpija, se s'ka sen n'to! – Krenar doli nga klasa për të vazhduar me grupin tjetër por me historinë e njëjtë. Dhe mos të harrojmë ta cekim, fajtor i krejt kësaj ngjarjeje ishte zgjedhur kamarieri i kafenesë, sepse kishte zgjedhur ta lëshonte këngën e Unikatilit në momentin më kritik! Shhhhh se po t'nin!



afati i prillit

Diagram i skenareve më të mundshme gjatë përgatitjes për provimet e prillit



Koha për ushtrime



Më poshtë shtrohet përpara jush nji detyrë. Duheni me i shkru kuptimet e fjalëve të dhëna në hapësirën e zbrazët.

Përshkrimi i detyrës:
Më një mesatare të lartë të gabimeve drejtshkrimore për faqe në librin e saj "Biznesi elektronik" (2011), Prof. Dr. Mihane Berisha-Namani ose Nimani (sepse edhe vetë emri i saj figuron ndryshe në pjesë të ndryshme të librit) e cila mban titullin e profesorit të rregullt në Fakultetin Ekonomik - UP, ka arritur që të krijojë nocione të reja që ju me siguri nuk i dini. Apo edhe i dini?

Ekonomin e re _____
Transakcion _____
Shoqërin informatike _____
Imixh _____
Hapsirave _____
Fitonë _____
Bashkokëhore _____
Nduhmën _____
Mbrendshme _____
Protokili _____
Të bayuar _____
Aspeht _____
Ramjes _____

Sasis _____
Disciplin _____
Ndikonjë _____
Teknolgjia _____
Kompjter _____
Mvaren _____
Shkarikimit _____
Jashtëzakonsihtë _____
Fatorët materjal _____
Mënyr _____
Shpërndarje të informative afariste _____

Tema: Si i kaluam pushimet dimërore

Shkruaje një hartim për pushimet dimërore.

Nëse të mungon inspirimi, fillo me një fjali si “U zgjova në mëngjes, një petk i bardhë kishte mbuluar parkun para shtëpisë sime...

Hartimin e përfunduar dërgo me email tek: gazeta.orca@gmail.com.

Hartimi më mirë do të botohet në numrin e ardhshëm të TD.